



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Hetimet për vdekjen e rusëve në pikën zero! Grupi Hetimor mori gabim mostrat e ujit dhe të klorit, ISHP i kthen mbrapsht! Kthimi i trupave peng i hetimeve
- 2

Aksion antidrogë me urdhër të SPAK në Lezhë, lëshohen 20 urdhër-arreste, nga të cilët 12 të ekzekutuara! Mes tyre të arrestuar 5 efektivë policie të përfshirë në kultivimin e kanabisit
- 3

Sapo mbaroi punën në fasoneri, 'Fuoristrada' përplas për vdekje 56-vjeçarin, e tërheq disa metra zvarrë dhe largohet nga vendngjarja
- 4

Gruaja që mund t'i japë fund karrierës politike të Vuçiqit!
- 5

5 efektivë të arrestuar Lezhë, Gladis Nano: Më keni krah, por asnjë tolerim ndaj atyre që neglizhojnë detyrën

Kronikë

## Qëlluan me armë zjarri dhe terrorizuan banorët, arrestohen dy të rinjtë në Vorë

Policia e Tiranës ka vënë në pranga dy të rinj në Vorë, pasi kanë qëlluar me armë zjarri në ajër. Arrestimi i tyre është kryer pas denoncimit të qytetarëve se në vendin e quajtur “Kuç-Vorë”, mbi kodrat e fshatit Gjokaj, po qëllohej me armë zjarri në ajër




Foto ilustruese

**[Sh]** Redaksia  
18 Tetor, 12:05 | Përditësimi i fundit: 18 Tetor, 12:06



Policia e Tiranës ka vënë në pranga dy të rinj në Vorë, pasi kanë qëlluar me armë zjarri në ajër. Arrestimi i tyre është kryer pas denoncimit të qytetarëve se në vendin e quajtur “Kuç-Vorë”, mbi kodrat e fshatit Gjokaj, po qëllohej me armë zjarri në ajër.

Pas lajmërimit, policia ka bërë të mundur kapjen në flagrancë të dy të rinjve, L. Ç., 23 vjeç dhe A. D., 24 vjeç, banues në Shijak.



**[Sh]**  
**LEXO EDHE:**  
**Hetimet për klandestinët zbulojnë shkeljet e policëve! 4 efektivë në Tiranë të arrestuar, 6 të pezulluar në Korçë, mes tyre dhe shefi i Komisarariatit dhe i 'rrugores'**

Gjatë kontrollit fizik dhe të automjetit të tyre u gjet një armë zjarri automatik, një sasi të vogël lënde narkotike kanabis dhe sende të tjera të kundërligjshme.

Në vijim të veprimeve hetimore, këta shtetas kanë rezultuar edhe autorë të ngjarjes së ndodhur më datë 03.10.2021, ku shtetasi B. V. ka kallëzuar se është qëlluar me armë zjarri në ajër dhe për pasojë është dëmtuar automjeti i tij.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje”, “Prishja e rendit dhe qetësisë publike” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Tirane policia tirane



Ndalohej rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



**Sondazhi i ditës:**  
**A jeni dakord me rekomandimin e Komitetit të Imunizimit për dozë të tretë vaksine për mbi 60 vjeçarët?**

Po Jo Nuk kam mendim

Komento

Lajme të tjera

Kronikë



Hetimet për vdekjen e rusëve në pikën zero! Grupi Hetimor mori gabim mostrat e ujit dhe të klorit, ISHP i kthen mbrapsht! Kthimi i trupave peng i hetimeve

20 Tetor, 16:08

Kronikë



Tiranë/ Menaxheri dhe punonjësja vjedhin kompaninë në shifrën e 3.5 mln lekëve, por në fund e pësojnë

20 Tetor, 15:41

Kronikë



Përmbarimi shkon të prishë Cirkun e Tiranës, aktorët shfaqje në shenjë proteste: Shpronësoni tokën që të mos ikim ose përgatisni një ambient të ri

20 Tetor, 12:11

Kultura



Ekspozita e piktorit Ismail Lulani, prezantohet për herë të parë në Muzeun Historik Kombëtar

19 Tetor, 16:26

Sociale



Tirana me ujësjellës të ri: Selitës, Shën Mërisë dhe Bovillës i shtohet edhe burimi i Gurit të Bardhë

19 Tetor, 14:05

Kronikë



Tiranë/ E zuri korrenti teksa po punonte, përfundon në spital elektrikisti 55-vjeçar

19 Tetor, 12:14

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju